

Njoftim për kërkim kandidaturash për ndjekje kualifikimesh

1	Titulli i kursit	Kolegji mbretëror i studimeve të mbrojtjes
2	Kriteret e kërkuara të gradës	Nënkolonel karriere të cilët e kanë kryer KLO, Kolonel të rinj, me perspektivë dhe/ose Gjeneral brigade si dhe civilë ekuivalent me këto grada.
3	Kriteret e kërkuara të gjuhës / gjuhëve	Anglisht mbi 90 pikë ALCPT
4	Përshkrimi	Qëllimi i kursit është të përgatisë ushtarakë e zyrtarë të niveleve të larta për pozicione të larta drejtuese e menaxhuese. Kjo do të arrihet duke zhvilluar aftësitë e të menduarit e të kuptuarit në nivel strategjik, nëpërmjet një analize të detajuar të axhendës ndërkombëtare të sigurisë; të faktorëve që ndikojnë në mjedisin e sigurisë; stabilitetin, prosperitetin si dhe elementëve kyç të drejtimit në nivel strategjik kombëtar. Gjithashtu kursi ka për qëllim të rrisë aftësitë e të kuptuarit dhe analizuarit përtej kufijve kulturor dhe ideologjik kombëtar.
5	Kriteri specialitetit	E pa aplikueshme
6	Periudha e zhvillimit të kursit	4 shtator 2023 – 17 korrik 2024
7	Vendi i zhvillimit të kursit	Londër, Mbretëri e Bashkuar
8	Afati aplikimit elektronik (sipas lidhjes 4)	27 mars 2023
9	Ekuivalentimi	me K-7
10	Të tjera	Të mos e ketë kryer këtë kurs më parë; Kandidatëve u lind e drejta për të aplikuar jo më herët se tre vjet pas përfundimit të një kursi tjetër institucional jashtë vendit. Moshë e pjesëmarrësve duhet të jetë në mesin e të 40-ve (dyzetave).

11 | Kuota

| 1 (një) kuotë